

# Një informacion i shkurtër

Si zhvillojmë ne në shkollën tonë  
bisedë me prindërit?

---

**Ne deshirojmë që të gjithë nxënëset dhe nxënësit të përparojnë mirë si personalisht ashtu edhe në shkollë.** Për të arritur këtë qëllim, është mirë që të ulen së bashku mësuesi dhe prindi – ndoshta edhe persona të tjerë të shkollës, që kanë të bëjnë me fëmijën – në një bisedë të përbashkët në shkollë.

**Në shkollën tonë këto bisedime kanë një rrjedhë të veçantë.** Kjo na ndihmon ne, që ti gjejmë temat së bashku, që me të vërtetë janë të rëndësishme. Ti shkëmbejmë vërtetimet dhe të gjejmë së bashku, se çfarë mund të bëjmë ne, për përmirësimin e situatës.

**Ky informacion i shkurtër përshkruan hapat e rëndësishëm të kësaj çështjeje.** Kush dëshiron informacione më të hollësishme, mund të lexojë në detaje në broshurën «Schulische Standortgespräche». Ajo mund të huazohet në shkollë.

---

## Kur bëhet biseda me prindërit?

Një bisedë ndërmjet mësuesit dhe prindit duhet të bëhet:

- nëse zhvillohet bisedë e rregullt prindërore, ose
- nëse nxënësja ose nxënësi ka vështirësi në shkollë, që duhen të vështrohen me kujdes dhe të diskutohen («Cilat janë shkaqet e këtyre vështirësive? Çfarë mund të bëjnë pjesëmarrësit për ta përmirësuar situatën? Në cilat forca duhet të bazohemi ne?»), ose
- nëse nxënësja ose nxënësi merr një masë speciale mbështetëse («A mund të sjellin sukses masat e marra? A janë masat edhe më tutje të rëndësishme? Ose a i nevojitet fëmijës diçka tjetër?»).

Një bisedë e parë mund të kërkohet nga të dyja palët si p.sh. nga mësuesi ose nga prindërit.

Nëse nxënësja ose nxënësi merr një masë speciale mbështetëse, atëherë mbahen takime të rregullta (zakonisht dy herë në vit, por më së paku një herë në vit).

---

## Kush merr pjesë në këtë bisedë?

Në bisedë duhet të marrin pjesë ata persona, të cilët mund të jenë të rëndësishëm për sqarimin e situatës. Pjesëmarrës janë gjithnjë: mësuesi dhe edukatori përgjegjës (babai dhe/ose nëna). Sesa e domosdoshme është edhe pjesëmarrja e fëmijës në bisedë, kjo varet nga situata e fëmijës.

Në bisedë mund të marrin pjesë edhe: një person i kualifikuar në pedagogjikën shëruuese shkollërore ose në terapi, drejtorja e shkollës ose psikologu i shkollës – ose një person tjetër që mund të japë një ndihmë të rëndësishme në këtë situatë.

Të gjithë pjesëmarrësit njoftohen nëpërmjet ftesës, se kush do të marrë pjesë në bisedë.

---

## Sa zgjat biseda?

Zakonisht biseda zgjat një orë.

<b>Kush e udhëheq bisedën?</b>	Shpeshherë biseda udhëhiqet nga një person me kualifikim të veçantë në pedagogji (p.sh. nga pedagogja shëruese e shkollës/pedagogu shërues i shkollës) ose nga mësuesi i fëmijës. Biseda mund të udhëhiqet gjithashtu edhe nga drejtorja e shkollës ose nga psikologja e shkollës/psikologu i shkollës/psikologja e shkollës.
<b>Kush ju fton në bisedë?</b>	Zakonisht në bisedë ju fton personi i cili e udhëheq bisedën.
<b>Si mund të përgatitesh për bisedën?</b>	Të gjithë pjesëmarrësit përgatiten për bisedën, duke plotësuar fletën «Përgatitje personale për bisedën ndërmjet prindërit dhe mësuesit në shkollë». Formulari për përgatitje ndihmon për të gjetur më shpejt së bashku, se cilat tema janë të rëndësishme, për të cilat duhet të bisedohet. Prindërit mundet ta plotësojnë formularin përgatitor vetë ose së bashku me fëmijën e tyre.
<b>Si plotësohet formulari përgatitor?</b>	Në formular ju mund të përshkruani me pak fjalë sipas mendimit tuaj situatën e tanishme: Çfarë vështirësish ka për momentin, çfarë është specifike? Cili është problemi me i rëndësishëm sipas mendimit tuaj? Ndoshta mund të jetë me rëndësi që ju të shkruani diçka për gjendjen shpirtërore të nxënësit. Është me rëndësi të dihet, nëse për shembull mbizotëron një gjendje shpirtërore gëzimi ose frike. Në vijim lexoni ju tërë formularin tejtejt dhe mendohuni tek të gjitha pikat, nëse ju përjetoni tek fëmija juaj më tepër një forcë ose probleme. Një fushë quhet për shembull «Sjellja me kërkesat». Nëse ju jeni të mendimit, se fëmija këtu pak a shumë vlerësohet si shokët e klasës të të njëjtës moshë, atëherë ju kryqëzoni kutizën në mes. Nganjëherë është vështirë të vendosësh vetëm një kryq. Në këtë rast ju mund të vendosni më shumë kryqe. Për vërejtjet shtesë, ka vend majtas. Formulari juaj i plotësuar qëndron në pronën tuaj. Ju mund ta merrni atë mbas bisedës përsëri me vete në shtëpi.
<b>Sa kohë nevojitet afërsisht për plotësimin?</b>	Merrni 5 deri 10 minuta kohë, jo më shumë. Sepse bëhet fjalë për një vlerësim të përgjithshëm, i cili mund të jetë shumë ndihmues për bisedën.
<b>Duhet të plotësohen të gjitha fushat?</b>	Jo. Nëse ju mendoni «Këtë unë smund ta vlerësoj» ose «Për këtë më mirë s'dua të them gjë», atëherë lëri zbrazët fushat përkatëse.
<b>Si zhvillohet biseda?</b>	Në pjesën e parë të bisedës bëhet vështrimi i vlerësimeve të ndryshme në formularët për përgatitje («Ku e kanë të gjithë të njëjtin vlerësim? A ka fusha, që janë të vlerësuara krejt ndryshe?»). Tani vendoset së bashku, për cilat (dy deri tre) fusha duhet të bisedohet thellësisht. Të gjithë pjesëmarrësit mund ti parashtrojnë vrojtimit e tyre. Në pjesën e fundit të bisedës parashtrohen pyetjet qëndrore : «Çfarë mund të bëjmë në konkretisht, për ta përmirësuar situatën?»
<b>A ka një protokollim të bisedës?</b>	Po, do të hartohet një protokoll i shkurtër. Protokollin do të trajtohet në mënyrë sekrete. Në fletën e fundit të protokollit shënohet, se cilat qëllime duhet të ndiqen së bashku ose ndoshta cilat masa duhet të merren ose të parashtrohen. Të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë në bisedë do të marrin një kopje të protokollit.
<b>Çfar mund të bëj unë, nëse kam akoma pyetje?</b>	Për paqartësitë, drejtohuni ju drejtpërdrejtë personit që ju ka ftuar në bisedë. Në qoftë se ju dëshironi të informoheni më hollësisht: Në shkollë ekziston një broshurë në lidhje me zhvillimin e bisedës ndërmjet mësuesit dhe prindërit «Schulische Standortgespräche». Aty procedura përshkruhet në detaje.